

## **SHPREHJE INTERESI**

Instituti i Statistikave, INSTAT është institucioni i cili mbulon fushën e Statistikave.

Në kuadrin e veprimtarive për integrimin evropian, INSTAT është institucioni përgjegjës për përputhshmërinë e akteve komunitare të parashikuara në Kapitullin 18 “Statistikat”, në bashkëpunim me agjensitë statistikore Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Aktet komunitare (acquis communautaire) në fushën e statistikave përbëhen nga legjislacioni i cili është direkt i zbatueshëm në Shtetet Anëtare të KE, siç janë Rregulloret e Parlamentit Evropian, Rregulloret e Këshillit Evropian, Vendimet e tyre dhe Rregulloret e Komisionit Evropian. Aktet komunitare mbi statistikën përbëjnë gjithashtu një gamë të gjerë të udhëzuesve metodologjikë në fusha të ndryshme statistikore si politikën ekonomike dhe monetare, statistikën demografike dhe sociale, statistikën sektoriale si Bujqësia, Energjia, Transporti, Turizmi, etj, si dhe inovacioni apo teknologjia e informacionit. Standardet ndërkombëtare si parimet themelore të statistikave dhe kodi i praktikave të statistikave evropiane ofrojnë parimet bazë mbi të cilat duhet të mbështetet prodhimi dhe përhapja e statistikave zyrtare.

Mbështetur në VKM nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” si dhe në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit të RSH, nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”, ftohet të marrin pjesë lirisht përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të mediave dhe grupeve të interesit, duke shprehur interesin e tyre për tu bërë anëtarë të tryezës së kapitullit të 18-të “Statistikat”, në kuadër të Grupeve Institucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE).

Do të vlerësonim shprehjen e interesit Tuaj brenda datës 15 Tetor, 2019 duke dërguar një letër interesi dhe CV-në tuaj ku tregoni ekspertizën apo interesin tuaj të mjaftueshëm për të qënë pjesë e tryezës për kapitulli 18 “Statistikat” në adresën [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al).

INSTAT do të shqyrtojë aplikimet e dorëzuara brenda një jave nga afati i sipërpërmendur për dorëzimin e aplikimeve.

Bashkëngjitur ftesës ndodhen baza përkatëse ligjore të cilën mund ta gjeni edhe në këtë link [http://instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018\\_per-statistikat-zyrtare.pdf](http://instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf). Ndërkohë, për më tepër informacion, lutemi të konsultoheni me faqen zyrtare të Institutit të Statistikave [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)